



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1370 datë 01.09.2010

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativë të Albanian Mobile Communications sh.a mbi VKD nr. 1332, datë 15.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a mbi VKD nr. 1264, date 28.04.2010 “Per miratimin e Termave te Pergjithshme të Kontratës (Kontrate Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 01.09. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e ankimit administrativë të Albanian Mobile Communications sh.a mbi VKD nr. 1332, datë 15.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a mbi VKD nr. 1264, date 28.04.2010 “Per miratimin e Termave te Pergjithshme të Kontratës (Kontrate Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 5, neni 99 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

www.akep.al

Fax : + 355 4 2259 106

info@akep.al

2. Neni 135 e vijues i ligj nr. 8485, date 12.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”
3. Ligji nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (**Ligj nr.9902**);
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
5. Vendim i Keshillit Drejtues nr.1332, date 15.07.2010 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a mbi VKD nr. 1264, datë 28.04.2010 “Për miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) se Albanian Mobile Communications sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të levizshme”;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacion shpjegues (**relacioni**);
- Projektvendim i KD (**projektakti**);
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Albanian Mobile Communications ka depozituar në AKEP brënda afateve ligjore procedurale shkresën nr. 1683/19, date 19.07.2010 (AKEP: nr. 334/7 prot, datë 02.08.2010) “Pergjigje Tuajes me nr. 334/6 date 19.07.2010 dhe Kërkesë ankimore administrative ndaj Vendimit nr. 1332 date 15.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a mbi VKD nr. 1264, date 28.04.2010 “Për miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) se Albanian Mobile Communications sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të levizshme”;
2. AMC ka kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të VKD nr. 1332, datë 15.07.2010 dhe pezullimin e efekteve të tij deri në marrjen e një vendimit të dytë nga AKEP duke kërkuar shtimin e paragrafit në pikën 17.2 “Përfundimi i kontrates” të Kontratës Tip “Kushtet e përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të levizshme për pajtimtarin” në kushte të njejta si të operatorëve Vodafone Albania sh.a dhe Eagle Mobile sh.a si më poshtë vijon:

“Në raste se mbarimi i kontrates kryhet nga Pajtimtari brënda afatit fillestarë të kontratës prej 12 (dymbëdhjete) muajsh, Pajtimtari ka detyrim të paguaj tarifën mujore fikse për të gjithë periudhën 12 (dymbëdhjetë) mujore”.
3. AMC i ka bashkengjitur kërkesës ankimore kushtet e miratuara nga AKEP të Kontratës Tip sipas pikës 2 të VKD nr. 1332 datë 15.07.2010;

4. AKEP, për sa më sipër konstaton se kërkesa e AMC është e drejtë dhe argumentuar bazuar në parimet e barazisë dhe proporcionalitetit që duhet të respektojë një organ administrative publik,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij dokumenti për sipërmarrësin dhe për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të ndryshojë pika 17.2 e VKD nr. 1332, datë 15.07.2010 dhe të pranojë kërkesën ankimore administrative të AMC me shkresën nr. 1683/19, datë 19.07.2010 (AKEP: nr. 334/7 prot, datë 02.08.2010) si më poshtë vijon:

“Pas shkëputjes së Pajtimtarit nga rrjeti si pasojë e mbarimit të kontratës ai është i detyruar të paguajë me kërkesë të AMC të gjitha shumat e parashikuara në paragrafin 5 dhe të gjitha tarifën e papaguara në castin e shkëputjes sipas listës së çmimeve. Në rastë se mbarimi i kontratës kryhet nga Pajtimtari brënda afatit fillestar të kontratës prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, Pajtimtari ka detyrim të paguajë tarifën mujore fikse për të gjithë periudhën 12 (dymbëdhjetë) mujore”.

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al dhe ti njoftohet sipërmarrësit AMC sh.a;
3. Albanian Mobile Communications sh.a. të publikojë në faqen e tij të Internetit termat e përgjithshme të kontratave Tip, të ndryshuara me këtë vendim;

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë :

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**